



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë Praktike (2)

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë seminare;

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor” në Përkthim dhe Interpretim ruse”

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda "Gjuhë praktike" (moduli 2) synon të nxisë drejtimin komunikativ të studentit, i cili duhet të përshkrojë gjithë procesin e mësimin në gjuhë të huaj. Gjatë këtij kursi studenti duhet të jetë në gjendje të ndërtojë dialogje, t'i përgjigjet pyetjeve, të përshkruaj mjedisin që e rrethon, të tregojë për veten, të afërmit dhe miqtë e tij, duke u mbështetur në atë minimum material gjuhësor, të përvetësuar gjatë etapës fillestare të të mësuarit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të bisedojnë për një bisedë të improvizuar;
2. Të kërkojnë një informacion ose të porosisin diçka në telefon; - të pyesin se ku ndodhet një rrugë apo një institucion i caktuar.
3. Gjatë leximit studentët do të kuptojnë tekste me strukturë të thjeshtë, mund të bëjnë një përmbledhje të shkurtër të një teksti të dhënë.
4. Gjatë dëgjimit ata do të kuptojnë më lehtë të folurën ballë për ballë. Me shkrim studentët do të fitojnë aftësinë që të shkruajnë një letër të shkurtër, e cila përbëhet nga fraza jo të gjata.

Rezultatet e pritshme.:

1. Studenti do të jetë në gjendje të zhvillojë dialogë të thjeshtë dhe të marrë pjesë në biseda të përditshme, si kërkesa për informacion, orientim në qytet apo porosi telefonike.
2. Do të kuptojë dhe përmbledhë tekste të shkurtra me strukturë të thjeshtë, duke evidentuar idetë kryesore dhe duke interpretuar përmbajtjen themelore.
3. Do të kuptojë të folurën në situata të thjeshta komunikimi ballë për ballë, si në situata sociale apo ndërveprime bazë.
4. Do të jetë në gjendje të shkruajë një letër ose tekst të shkurtër informal, duke përdorur fraza të sakta dhe të përshtatshme për kontekstin.